



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1392/24, Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë), nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031(GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit Rezonanca për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Infermieri BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;*
- II. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit Rezonanca për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Fizioterapi dhe Mjekësi Sportive MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
 2. *Fizioterapi BSc 240 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Rezonanca që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji Rezonanca të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Rezonanca brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Infermieri BSc 180 ECTS R</i>	Anila Dine Milazim Gjocaj Emanuela Prendi
2.	<i>Fizioterapi dhe Mjekësi Sportive MSc 120 ECTS A</i>	Ilir Smailaj Ismet Bajraktari
3.	<i>Fizioterapi BSc 240 ECTS A</i>	Bekim Haxhiu Zheraldin Durguti Klejda Tani Ismet Shalaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Rezonanca.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Infermieri BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik, Joke Denekens, Snjezana Schuster dhe Nibal Sabri, është organizuar më 29.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht katër (4) dhe pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Fizioterapi dhe Mjekësi Sportive MSc 120 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joke Denekens, Danica Zeleznik, Snjezana Schuster dhe Nibal Sabri është organizuar më 29.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) Substancialisht tre (3) dhe pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Fizioterapi BSc 240 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joke Denekens, Danica Zeleznik, Snjezana Schuster dhe Nibal Sabri është organizuar më 29.04.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht tre (3) dhe pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Rezonanca dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Rezonanca;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

